

20222854297

Në bazë të nenit 34 paragrafi (9) të Ligjit për lëndë të para minerale (*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16, 120/16, 189/16, 7/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 99/22), ministri i Ekonomisë miratoi

RREGULLORE PËR MËNYRËN E PUNËS SË KOMISIONIT PËR USHTRIMIN E VLERËSIMIT (REVIZIONIT) PROFESIONAL TË DOKUMENTACIONIT GJEOLGJIK

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Komisionit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të dokumentacionit gjeologjik.

Neni 2

Komisioni për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të dokumentacionit gjeologjik (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) punon në seancën përgatitor dhe seancat, në përbërje të plotë nga kryetari, së paku dy anëtarë dhe sekretar, ndërsa merr vendim me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Neni 3

Nëse në seancën përgatitore të Komisionit përcaktohet se kërkesa për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional nuk është në përputhje me nenet 4, 5 dhe 6 të Rregullores për mënyrën e ushtrimit të vlerësimit (revizionit) profesional të dokumentacionit gjeologjik, Komisioni në afat prej shtatë ditëve i dorëzon njoftim kërkuesit në të cilin përcakton afatin në të cilin kërkuesi duhet të bëjë plotësimin e kërkesës, afat ky që nuk mund të jetë më i gjatë se 10 ditë nga dita e pranimit të njoftimit.

Nëse edhe pas afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, kërkuesi nuk e dorëzon dokumentacionin e nevojshëm, kërkesa refuzohet nga Komisioni me aktvendim.

Neni 4

Para mbajtjes së seancës së Komisionit, kryetari dhe anëtarët e Komisionit përpilojnë raport me shkrim në raport me vlerësimin (revizionin) profesional të dokumentacionit gjeologjik.

Në seancën e Komisionit marrin pjesë kryetari, anëtarët dhe sekretari i Komisionit, si dhe kërkuesi dhe përpiluesi i dokumentacionit gjeologjik.

Në seancën e Komisionit nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit, si dhe kërkuesi dhe përpiluesi i dokumentacionit gjeologjik shqyrtohet raporti me shkrim nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 5

Për rrjedhën e seancës së Komisionit përpilohet procesverbal, në të cilin veçanërisht bëhet e ditur:

- data dhe vendi i mbajtjes së seancës së Komisionit;
- emri dhe mbiemri i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit, si dhe i përfaqësuesit të kërkuesit dhe të përpiluesit të dokumentacionit gjeologjik;
- përshkrim i shkurtër i rrjedhës së seancës së Komisionit dhe
- klauzolë e revizionit dhe raport i revizionit të Komisionit.

Procesverbalin nga paragrafi 1 i këtij neni e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e Komisionit, si dhe përfaqësuesi i kërkuesit dhe përpiluesi i dokumentacionit gjeologjik.

Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 24-5414/1
9.12.2022
Shkup

Ministri i Ekonomisë,
Kreshnik Bekteshi, d.v.